



Pranuar / Dorezuar Priljenor/Pridato Received/Deliverty	12.04	2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKOMSHDL	2016/2022		1/5	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.117/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, Eshref Shabani dhe Jeton Kocanëtarë, si dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.117/2022 të datës 11.02.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted] të cilin me autorizim e përfaqëson av. [redacted] me adresë rruga [redacted] kundër Vendimit me numër Nr.ref:65/2022 të datës 07.02.2022 të zëvendës Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike 'kërkesë nga marrëdhënia e punës', duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 12.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.117/2022 e datës 11.02.2022, e parashtruar nga ankuesi [redacted]

II. SHFUQIZOHET Vendimi me Nr.ref:65/2022 i datës 07.02.2022 i Zëvendës Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës sipas Akt emërimit të datës 05.09.2012 në pozitën "Zyrtar i lartë për marrëdhënie dypalëshe", ndërsa me datën 31.08.2021 Zëvendës Kryeministrja dhe Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ka nxjerrë Vendim me numër Nr.Ref.293/2021 sipas të cilit vendim ankuesi me gradë diplomatike Sekretar i Parë caktohet të shërbejë në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Londër/Mbretërinë e Bashkuar nga data 01.10.2021 me mandat katër (4) vjeçar.

Zëvendës Kryeministrja dhe Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datën 11.11.2021 nxjerrë Vendim me numër Nr.Ref.438/2021, sipas të cilit ankuesin me gradën Sekretar i Parë e në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Londër/Mbretërinë e Bashkuar e kthen/tërheq nga misioni diplomatik nga data 12.11.2021.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin e Zëvendës Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës me numër Nr.ref:438/2021, të datës 11.11.2021 lidhur me tërheqjen dhe kthimin e tij nga Ambasada e Republikës së Kosovës në Londër/ Mbretërinë e Bashkuar, me datën 24.11.2021 përmes përfaqësuesit të tij, ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5640/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, me datën 30.11.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministria e Jashtme dhe Diasporës, ndërsa me datën 21.12.2021, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës përmes Divizionit për Burime Njerëzore, ka përcjellë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

Me datën 15.03.2021, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerr Vendim me numër A.nr.963/2021, me të cilin ka shfuqizuar vendimin me numër Nr.ref.438/2021 të datës 11.11.2021, si dhe ka detyruar Zëvendës Kryeministren dhe Ministren e Punëve të Jashtme dhe Diasporës që t'a rishqyrtoj lëndën e ankuesit.

Zëvendës Kryeministrja dhe Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me datën 07.02.2022, ka nxjerrë Vendim me numër Nr.ref.65/2022, sipas të cilit ka shfuqizuar vendimin me numër Nr.ref.438/2021 të datës 11.11.2021 bazuar në vendimin e Këshillit dhe ka lënë në fuqi pjesën ku konfirmohet tërheqja/kthimi nga Misioni në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin me numër Nr.ref.65/2022 të datës 07.02.2022 të Zëvendës Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datën 11.02.2022, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 689/2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 24.11.2021 me Nr.Prot:5640/2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër Nr.Ref:438/2021 i datës 11.11.2021 nga Zëvendës Kryeministrja dhe Ministrja e Punëve të Jashtme; Vendimin me numër Nr.Ref:293/2021 i datës 31.08.2021 nga Zëvendës Kryeministrja dhe Ministrja e Punëve të Jashtme; Kërkesën e datës 28.10.2021 nga ankuesi për zv.Sekretaren e Përgjithshme të MPJD-së; Kërkesën e datës 03.11.2021 nga ankuesi për zv.Sekretaren e Përgjithshme të MPJD-së; Procesverbalin e datës 05.11.2021; E-mailin zyrtar të datës 17.11.2021; E-mailin zyrtar të datës 09.11.2021; E-mailin zyrtar të datës 05.11.2021; Listën me e-mailat zyrtar të datës 17.11.2021 ndërmjet ankuesit dhe zëvendës Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Akt emërimit të ankuesit të datës 05.09.2012; Vendimin me numër Nr.Ref: 092/2015 të datës 30.12.2015; Autorizim i datës 17.11.2021 nga përfaqësuesi ligjor i ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 30.11.2021 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 21.12.2021 nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me shkresat e bashkangjitura të lëndës ; Akt emërimit me numër AE.Nr.16/2021 të datës 19/02/2021; Vendimin me numër Nr.Ref:235/2021 nga Zv.Sekretarja e Përgjithshme e MPJD-se për ankuesin; Formularin -PDP mbi përkrahimin e detyrave të punës së ankuesit; E-mailin zyrtar të datës 09.11.2021; Kërkesën e datës 18.10.2021 nga ankuesi për Zv.Sekretaren e Përgjithshme të MPJD-së; E-mailin zyrtar të datës 05.11.2021; E-mailin zyrtar të datës 08.11.2021; E-mailin zyrtar të datës 05.11.2021 lidhur me fotografitë për çmimet e

banimit; Udhëzimin administrativ me numër Nr.01/2018 për plotësimin dhe ndryshimin e udhëzimit administrativ Nr.03/2012 për shpenzimet personale dhe operacionale në misionet diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës; Udhëzimin administrativ me numër Nr.03/2018 për plotësimin dhe ndryshimin e udhëzimit administrative me numër Nr.03/2012 për shpenzimet personale dhe operacionale në misionet diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës; Vendimi VK.Nr.70/2021 i datës 31.12.2021 i Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për zgjatjen e afatit të lëndës së ankuesit

Vendim me numër A.nr.963/2021 i datës 15.03.2021 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër Nr.ref.65/2022 të datës 07.02.2022 të Zëvendës Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Ankesën me numër të protokollit 689/2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi VK.Nr.22/2022 i datës 25.03.2022 i Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për zgjatjen e afatit të lëndës së ankuesit

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave ka konstatuar se Zëvendës Kryeministria dhe Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me datën 07.02.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.ref.65/2022, sipas të cilit ka shfuqizuar vendimin me numër Nr.ref.438/2021 të datës 11.11.2021 bazuar në vendimin e Këshillit dhe ka lënë në fuqi pjesën ku konfirmohet tërheqja/kthimi nga Misioni në Ministrinë e Punëve të Jashtme me arsyetimin se ankuesi ka kryer shkelje sipas nenit 23 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, me arsyetimin se i njëjti ka kryer shkelje të detyrave të punës respektivisht ka shkelur obligimet ligjore që rrjedhin nga neni 32 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.6 të Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës siç përcaktohet se: "1. Nëpunësi i shërbimit të jashtëm ka për detyrë: 1.1. të ushtrojë me ndershmëri dhe korrektësi funksionet dhe detyrat e ngarkuara, në përputhje me urdhrat, udhëzimet dhe rregulloret e Ministrisë së Punëve të Jashtme, aktet ndërkombëtare dhe me legjislacionin e Republikës së Kosovës; 1.2. të mbajë përgjegjësi të plotë për ligjshmërinë e veprimeve gjatë kryerjes së detyrës; 1.3. të mbrojë interesat e shtetit të Kosovës dhe të shtetasve dhe personave juridikë të Republikës së Kosovës në shtetin ose shtetet ku është akredituar dhe ushtron funksionet e tij; 1.4. të zbatojë rregullat për informacionin e klasifikuar edhe pas largimit nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe të sigurojë ruajtjen e të dhënave dhe të informatave që i janë besuar; 1.5. të pezullojë aktivitetin e tij në një parti, organizate ose shoqate politike gjatë periudhës në shërbimin e jashtëm; 1.6. të mbajë, në të gjitha rrethanat, një qëndrim moral të denjë dhe profesional; 1.7. të mos bëjë deklaratat që bien në kundërshtim me qëndrimin e Republikës së Kosovës në marrëdhënie me shtetet e tjera ose organizatat ndërkombëtare; 1.8. të respektojë ligjet dhe rregulloret e shtetit ose të shteteve ku është akredituar, dhe të mos përfshihet në veprimtari të cilat mund të vlerësohen si ndërhyrje në punët e brendshme të shtetit ose të shteteve ku zhvillon veprimtarinë; 1.9 të ushtrojë veprimtarinë e vet në përputhje me imunitetet dhe privilegjet që gëzon si anëtar i misionit diplomatik; 1.10 të mos ushtrojë në shtetin ose shtetet ku është akredituar veprimtari tregtare ose çdo veprimtari tjetër fitimprurëse për llogari të tij ose të familjes së tij. 2. Shkelja e një detyrimi paraqet arsye për masë disiplinore".

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka analizuar dispozitat e Ligjit nr.03/L-122 për Shërbimin e

Jashtëm të Republikë së Kosovës, lidhur me tërheqjen e parakohshme nga misioni diplomatik, ku në nenin 23 përcaktohet se: "1. Presidenti i Republikës së Kosovës urdhëron tërheqjen e një ambasadori apo shefi të misionit nga misioni diplomatik përpara mbarimit të afatit të caktuar, për arsye të mëposhtme: 1.1. për nevoja pune në Ministrinë e Punëve të Jashtme; 1.2. në bazë të kërkesës së vetë përfaqësuesit diplomatik; 1.3. për arsye të vlerësimit negativ të punës së përfaqësuesit diplomatik; 1.4. për shkelje të dispozitave të këtij ligji ose të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi; 1.5. kur një gjë e tillë kërkohet nga shteti pranues. 2. Tërheqja e të gjithë përfaqësuesve të tjerë diplomatikë, duke mos e përfshirë shefin e misionit, për të njëjtat arsye të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, bëhet me urdhërin e Ministrit të Punëve të Jashtme", ndërsa paragrafi 2 i nenit 23 i të njëjtit ligj përcakton se: "Tërheqja e të gjithë përfaqësuesve të tjerë diplomatikë, duke mos e përfshirë shefin e misionit, për të njëjtat arsye të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, bëhet me urdhërin e Ministrit të Punëve të Jashtme", andaj Zëvendës Kryeministrja dhe Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me datën 07.02.2022 me rastin e nxjerrës së vendimit me numër Nr.ref.65/2022 ka vepruar në kundërshtim me nenin 30 paragrafi 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikë së Kosovës ku përcaktohet se: "Komisioni i Gradave dhe i Disiplinës ka për detyrë: 1.3. shqyrtimin e rasteve të shkeljeve të rënda të kryera nga nëpunësit e shërbimit të jashtëm dhe propozimin të Ministri i Punëve të Jashtme i masave disiplinore për nëpunësit që kanë kryer këto shkelje" si dhe në kundërshtim me nenin 12 paragrafi 1 të Rregullores Nr.02/2009 për Shërbimin e Jashtëm ku përcaktohet se: "Me këtë rregullore themelohet Komisioni për Grada dhe Disiplinë, me qëllim të shqyrtimit të rasteve të shkeljeve të rënda të etikës dhe të udhëzimeve të Ministrisë ose Ambasadorëve/Të ngarkuarve me punë/Shefave të Misionit, veprimeve të jashtëligjshme dhe sjelljeve të tjera që janë të palijshme për një anëtar të Shërbimit të jashtëm" si dhe në kundërshtim edhe me nenin 15 paragrafi 1 të së njëjtës rregullore ku përcaktohet se: "Eprori i drejtpërdrejtë propozon masën disiplinore tek komisioni ndaj zyrtarit gjegjës siç përcaktohet me këtë rregullore", pasi që sipas paragrafit 2 të nenit 32 të Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikë së Kosovës ku përcaktohet se "Shkelja e një detyrimi paraqet arsye për masë disiplinore", ndërsa në rastin konkret për shkeljet e supozuara disiplinore të ankuesit, nuk është iniciuar rasti nga eprori i tij i drejtpërdrejtë në Komisionin e Gradave dhe i Disiplinës dhe as nuk ka vendim nga Komisioni i Gradave dhe i Disiplinës që e konfirmon shkeljen e supozuar sipas vendimit me numër Nr.ref.65/2022 të datës 07.02.2022, andaj Kolegji konstaton se meqenëse me rastin e nxjerrjes së vendimit të atakuar ka pasur shkelje procedurale nuk ka mundur të konstatoj nëse ankuesi ka kryer shkelje ligjore apo jo ngase mungon vendosja apo shqyrtimi për rastin në fjalë nga ana e Komisionit të Gradave dhe i Disiplinës siç përcaktohet me nenin 12 paragrafi 1 të Rregullores Nr.02/2009 për Shërbimin e Jashtëm si dhe nenin 30 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikë së Kosovës, ndërsa ankesën e ankuesit e ka aprovuar për shkak të shkeljeve procedurale të ligjit material me rastin e nxjerrjes së vendimit nga Zëvendës Kryeministrja dhe Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Kolegji vlerëson se tërheqja e përfaqësuesve diplomatikë para mbarimit të afatit të caktuar mbetet në diskrecion dhe kompetencë të Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme në rastet e përcaktuara sipas nenit 23 paragrafit 1 të Ligjit nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës respektivisht për nevoja të institucionit, mirëpo në asnjë rrethanë nuk ka kompetencë të tërheqë përfaqësuesin diplomatik për shkak të supozimeve të shkeljeve ligjore sipas nenit 23 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikë së Kosovës pa u konfirmuar dhe vendosur paraprakisht nga një organ kolegjal siç është Komisioni i Gradave dhe i Disiplinës, ngase këtë kompetencë sipas nenit 12 paragrafi 1 të Rregullores Nr.02/2009 për Shërbimin e Jashtëm si dhe nenit 30 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit nr.03/L-



122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikë së Kosovës, e ka Komisioni i Gradave dhe i Disiplinës i cili është përgjegjës të shqyrtojë shkeljet e supozuara ligjore, të konstatoj apo jo shkeljen e supozuar dhe t'i propozoj Ministrin të Punëve të Jashtme masat disiplinore për nëpunësin i cili ka kryer shkeljet e supozuara.


Andaj, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore sikurse edhe analizimit të dispozitave ligjore respektivisht ligjit material në rastin konkret si dhe të gjeturave të pasqyruara në këtë vendim, ka konstatuar se vendimi me numër Nr.ref.65/2022 i datës 07.02.2022 i nxjerrë nga Zëvendës Kryeministrja dhe Ministra e Punëve të Jashtme dhe Diasporës është i paligjshëm siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 si dhe nën paragrafi 1.5 ku përcaktohet: "Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 5. është në kundërshtim me ligjin material", pasi që sipas nenit 30 paragrafi 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikë së Kosovës i takon Komisionit të Gradave dhe Disiplinës të shqyrtojë dhe vendos nëse pala apo ankuesi në rastin konkret ka kryer veprime që mund të përbëjnë shkelje ligjore apo mos përmbushje të detyrave të punës, andaj në rastin konkret të pasqyruar si më lartë është shkelur ligji material që rregullon shërbimin e jashtëm diplomatik, dhe mbi këtë bazë Kolegji konstaton se për shkak të shkeljeve të evidentuara ligjore procedurale vendimi me numër Nr.ref.65/2022 i datës 07.02.2022 i nxjerrë nga Zëvendës Kryeministrja dhe Ministra e Punëve të Jashtme dhe Diasporës është shfuqizuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me shumicë të votave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.117/2022

Ardita Perçuku-Shyti


Procesmbajtëse

Malsore Gashi-Bajraktari


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Njësive së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.